



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 12, Datë 09.01.2020

**PËR
EMËRIMIN GJYQATAR TË Z.XHEVDET LIKA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136/a dhe 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 35 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin nr.240, datë 24.10.2019, “Për kualifikimin e kandidatit z.Xhevdet Lika dhe vijimin e procedurës së emërimit si gjyqtar”, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I :

1. Të emërojë gjyqtar z.Xhevdet Lika.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet gjyqtarit të emëruar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR